



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 250, Datë 08.10.2025

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“GET SOLAR SOLUTION” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 *“Për sektorin e energjisë elektrike”*, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 08.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2499/1 prot., datë 02.10.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve *“Mbi kërkesën e shoqërisë “GET Solar Solution” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”*,

Konstatoi se:

- Shoqëria “GET Solar Solution” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2499 prot., datë 23.09.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 24 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 3164, fshati Rehovë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Kolonjë, Qarku Korçë.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas gërmave (a, b dhe c), si dhe ka kryer pagesën e aplikimit sipas Aneksit A.
- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas gërmave a, c dhe d.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas gërmave a dhe c.
- Në përputhje me nenin 9, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas gërmave b dhe e.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

- Shoqëria ka depozituar Kontratën “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 24 MW, dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, zonën kadastrale nr. 3164, Fshati Rehovë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Kolonjë, Qarku Korçë, nga shoqëria “GET SOLAR SOLUTIONS” sh.p.k. ”, datë 02.06.2025, nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe “GET Solar Solutions” sh.p.k.
- Shoqëria ka depozituar shkresën e OST sh.a. të datës 03.04.2024, për miratimin në parim të pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e transmetimit.
- VNM Paraprake, datë 27.03.2024, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për Personin Juridik “GET Solar Solutions” sh.p.k., për të zhvilluar projektin: “CENTRALI FOTOVOLTAIK VODICA SOLAR PARK 24 MWP”.
- Në këtë aplikim, shoqëria duhet të plotësojë dhe sa vijon:

NENI 9 - Formatit dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- Dëshmitë e penaltetit për vetë shoqërinë dhe administratorin e saj (**gërma b**).

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- Dokumentacion vërtetues të disponimit të mbështetjes financiare për të mbuluar vlerën e investimit sipas kontratës me MIE-n, pasi nuk ka depozituar asnjë dokument për financimin e projektit (**gërma b**).

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- Informacion mbi datën në të cilën parashikohet të fillojë operimi i centralit. (**gërma a**).
- Miratimin përfundimtar/marrëveshjen për pikën e lidhjes të nënshkruar me OST sh.a. (**gërma c**).
- Rezulton se shoqëria disponon një VNM të vlefshme, por duke qenë se në shtojcën 2 në zbatim të Rregullores, ajo ka deklaruar se punimet do të fillojnë në vitin 2025, vlerësohet t’i kërkohej të bëjë me dije në rast se ka filluar ndërtimi i centralit.

- Po ashtu, vlerësohet që të sqarohet me shoqërinë se si është ndjekur nga ana e saj zbatimi i detyrimit në lidhje me kapacitetin e instaluar të centralit (që buron nga kontrata me MIE-n) në paraqitjen e aplikimeve për marrjen e lejeve apo miratimeve përkatëse nga organet e tjera, pasi rezulton se miratimi në parim i pikës së lidhjes dhe Vendimi për VNM Paraprake janë dhënë për një kapacitet të ndryshëm nga ai që është përcaktuar në kontratë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GET Solar Solution” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 24 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 3164, fshati Rehovë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Kolonjë, Qarku Korçë, për një afat 30-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “GET Solar Solution” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI